VENDIM
Nr. 2, datë 15.3.2022

PËR ZGJEDHJEN E Z. SANDËR BECI ANËTAR TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, e përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Sadushi	zëvendëskryetar;
Ilir Panda	anëtar;
Ervin Pupe	anëtar;
Medi Bici	anëtar;
Sokol Binaj	anëtar;
Albana Boksi	anëtare;
Sandër Simoni	anëtar;
Artur Kalaja	anëtar;
Asim Vokshi	anëtar;
Arbena Ahmeti	anëtare;
Gentian Medja	anëtar.

Në mbledhjen e datës 15.3.2022, e cila kishte në rend të ditës zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, që është në emërtesë të saj,

VËREN:

1. Sipas nenit 125 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjykata e Lartë është një nga organet që zgjedh 3 (tre) anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.

2. Mbi bazën e njoftimit të Gjykatës Kushtetuese për krijimin e një vendi vakant, që sipas formulës së përcaktuar në Kushtetutë është në emërtesën e Gjykatës së Lartë, kjo e fundit rishpalli thirrjen e shprehjes së interesit për plotësimin e vendit vakant në datën 3.6.2021, për shkak të mosplotësimit nga thirrjet e mëparshme.

3**.** Lista e kandidatëve që aplikuan së bashku me dokumentacionin shoqërues iu përcoll Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, organ që ka në kompetencë kryerjen e verifikimit të kushteve dhe të kritereve ligjore, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve.

4. Në përfundim të procesit të shqyrtimit të kandidaturave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 31.12.2021, Gjykatës së Lartë iu përcoll lista e kandidatëve së bashku me raportin dhe dokumentacionin përkatës.

5. Gjykata e Lartë, në datën 26.1.2022, zhvilloi mbledhjen për të zgjedhur kandidatin për anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Për shkak të mungesës së kuorumit ligjor (me të paktën 10 gjyqtarë), Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve vendosi shtyrjen e saj deri në momentin e plotësimit të trupës gjyqësore me numrin e nevojshëm të gjyqtarëve që lejon vlefshmërinë e mbledhjes.

6. Në datat 16.2.2022 dhe 7.3.2022, u emëruan dy gjyqtarë të rinj në Gjykatën e Lartë, fakt i cili bëri të munduar plotësimin e kuorumit ligjor të nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes. Për këtë arsye, Mbledhja e Posaçme vendosi të procedojë fillimisht me miratimin e rregullave specifike për mënyrën e procedimit të mbledhjes për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

7. Me vendimin nr. 1, datë 24.2.2022, u miratua "Rregullorja e Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese", në të cilën u përcaktuan procedurat dhe modalitetet e zhvillimit të procesit të votimit për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

8. Mbi bazën e Rregullores së sipërcituar, si dhe referuar listës së kandidatëve të përcjellë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë, me urdhrin nr. 46, datë 1.3.2022, miratoi fletën tip të votimit për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese. Fleta e votimit përmbante listën me këta kandidatë: Alket Jaupi, Sandër Beci dhe Ervin Karamuço.

9. Në datën 3.3.2022, zëvendëskryetari njoftoi gjyqtarët e Gjykatës së Lartë për zhvillimin e mbledhjes për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese në datën 15.3.2022.

10. Në Mbledhjen e Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë morën pjesë të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë (11 gjyqtarë), duke plotësuar numrin e mjaftueshëm për vlefshmërinë e mbledhjes dhe realizimin e procesit të zgjedhjes së anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

11. Në datën 11.3.2022, kandidati Ervin Karamuço paraqet kërkesën për të hequr dorë nga procesi i votimit. Në kushtet kur zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë e kishte miratuar paraprakisht fletën e votimit (datë 1.3.2022) dhe duke qenë se dorëheqja e kandidatit Ervin Karamuço është paraqitur më pas, Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë konkludoi se mbetet e pandryshuar lista me renditjen e kandidatëve të paraqitur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

12. Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve zhvilloi procesin e votimit, i cili është i fshehtë. Për administrimin e procesit të votimit u krijua një komision votimi i posaçëm, i cili përbëhej nga Kancelari i Gjykatës së Lartë, kryesekretarja dhe një sekretare gjyqësore.

13. Në përfundim të procesit të votimit, Komisioni i votimit, pas numërimit të fletëve të votimit dhe të votave, deklaroi numrin e votave të marra nga kandidatët, nga ku rezultoi se kandidati z. Sandër Beci mori 7 (shtatë) vota, ndërsa 4 (katër) vota nuk ishin për asnjërin nga kandidatët.

14. Sipas nenit 7/"ç", pika 4, e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese nevojitet një shumicë prej 3/5 të gjyqtarëve të pranishëm. Në kushtet kur kandidati z. Sandër Beci, fitoi shumicën e votave (7 nga 11 vota) të nevojshme nga ligji, ky kandidat konsiderohet i zgjedhur në detyrën e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1, të nenit 125, të Kushtetutës dhe të nenit 7/"ç", të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), bazuar në rezultatet e votimit të zhvilluar në datën 15.2.2022 për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë

VENDOSI:

1. Z. Sandër Beci zgjidhet anëtar i Gjykatës Kushtetuese.

2. Ky vendim i dërgohet Kryetarit të Kuvendit, Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

3. Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare dhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

Zëvendëskryetar: Sokol Sadushi

Anëtarë: Ilir Panda, Ervin Pupe, Medi Bici, Sokol Binaj, Albana Boksi, Sandër Simoni, Artur Kalaja, Asim Vokshi, Arbena Ahmeti, Gentian Medja